



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:051085  
Datë: 08.06.2022  
Numri i dokumentit: 03110271

**C.nr.1002/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtarja Liridona Haziri Mustafa, me bashkëpunëtorin profesional Faton Lakna, në çështjen kontestimore të paditëses M. S. nga Gjilani Rr. “...” nr..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Arton Ibrahim nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Maliqi nga Gjilani, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar, shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit në punë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik më datën 01.06.2022, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M. S. nga Gjilani, dhe obligohet e paditura që paditëses t’ia paguaj dhe atë ë emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës shumë prej 210,50 €, në vlerë prej 50 % të një page bazë (421.00€), në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë shumë prej 1,362.00 euro (për 681 ditë pune) dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë, shumë prej 476.70 euro në vlerë prej 70 % të qmimit të biletës prej (1.00€ për 681 ditë pune), gjithësej shumë e përgjithshme prej 2,049.20 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

**II. OBLIGOHET** e paditura që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 270 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm .

**A r s y e t i m**

Paditësja në këtë gjykatë më datë 10.04.2020, përmes të autorizuarit të saj Atron Ibrahimimi avokat nga Gjilani, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, kurse me parashtrësën e dt.06.05.2022, ka bërë ndryshimin e padisë në aspektin objektiv, duke bërë zmadhimin e kërkespadiës për sa i përket ditëve të pranisë në punë, si dhe lartësisë së kompensimit për ushqim dhe udhëtim për ditët e pranisë në punë, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e sajë, me ndryshimet si në parashtrësën e lartëcekur si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguaj shumën prej 210,50 €, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilarë për mbi 10 vite të përvojës së punës në vlerë prej 50% të një (1) page bazë prej (421.00 €), si dhe për 681 ditë të pranisë në punë ne emer të shpenzimeve për ushqim shumën prej 1,362.00 €, kurse në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën prej prej 476.70 €, në vlerë të 70 % të qmimit të biletës prej (1.00€), me kamatë ligjore prej 8 % ne vit, duke filluar nga dita e ushtrimit te padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadiinë e paditëses për arsye se paditësja kërkesëpadiinë e sajë e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e miratuar dhe nënshkruar nga MASHT (Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë), dhe SBASHK(Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 5, 7 dhe 8 të kësaj kontrate, gjersa ka konsideruar se kjo kontratë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komuës së Gjilanit, si e paditur në këtë rast. Po ashtu ka theksuar se kjo kontratë nuk është në fuqi për disa arsye konkrete: Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti i dt. 06.05.2014, nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadiës dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Tutje ka theksuar se kjo kontratë kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Sipas Ligjit të Mardhënies të Detyrimeve, dhe Ligjit të Punës këmi edhe parashkrim të kërkesës për shkak se paditësja tash më ka mbi 10 vite përvojë pune, ndërsa dihet që një e drejtë e tillë i ka takuar pasi që paditësi i ka bërë 10 vite përvojë pune, që don të thotë se një kërkesë e tillë është paraqitur pas 3 viteve. Përveç tjerave, e paditura ka theksuar se sipas nenit 90 pika 8 e Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e lartëcekur. Përveq kësja e njëjta konsideron se kjo kërkesë është vjetërsuar edhe konform Ligjit të Punës neni 78 pika 1 ngase nuk është adresuar asnjë kërkesë punëdhënësit me qëllim që në procedurë administrative të realizoj këtë të drejtë e që mendojmë se kjo çështje është primare që të zgjidhet paraprakisht para se të dorëzohet padia në gjykatë, dmth në rastin konkret nuk janë shterrur mjetet e mbrenshme adminsintrative, ku neni 79 i Ligjit të Punës parasheh afatin prej 30 ditëve të realizimit të kësaj kërkesë, si dhe neni 82 i të njëjtit ligj që specifikon se Inspektoriati i Punës është autoriteti zyrtar i zgjidhjes së kërkesave të kësaj natyre. Andaj nga këto arsyei ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadija e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata me qëllim të zbatimit të parimit të ekonomizimit dhe interesit juridik të palëve në procedurë, pas mbajtjes se seancës përgatitore konform nenit 420 pika 3 të LPK-së, ka vazhduar menjëherë me mbajtjen e shqyrtimit kryesor.

I autorizuari e paditëses si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë thënieve në padi dhe kërkesëpadi të dorëzuar në gjykatë me datë 10.04.2020, si dhe ndryshimeve të bëra sipas parashtresës së dt.06.05.2022, duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses sipas ndryshimeve të bëra me parashtresën e lartëcekur dhe të detyrohet e paditura që paditëses M. S. nga Gjilani, t'ia paguaj për mbi 10 vite të përvojës së punës në emër të shpërblimit jubilar shumë prej 210.50 €, në vlerë të 50 % të një page bazë prej (421.00 €), si dhe për 681 ditë të pranisë në punë në emer të shpenzimeve për ushqim shumë prej 1,362.00 €, kurse në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumë prej prej 476.70 €, në vlerë të 70 % të qmimit të biletës prej (1.00€), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, duke filluar nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Gjithashtu e njejtja i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 270.00 €, duke i specifikuar edhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për taksë gjyqësore shumë prej 31 dhe për një seancë të mbajtur shumë prej 135 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrimin.

Gjykata në këtë qështje juridike kontestimore gjeti se për palët ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, për të paditurën nuk është kontestuese as lartësia e kërkesëpadiës, mirëpo si kontestuese për palën e paditur është baza juridike e padisë, pasi që e paditura konsideron se nuk është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit.

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë qështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: Kontratën e punës lëshuar nga e paditura me nr..... e dt.01.09.2015; Vërtetimet me nr..., të dt., lëshuar nga SHFMU “..” në Fsh... K.Gjilan, për përvojën e punës dhe ditët e pranisë në punë; Formularin së bashku me kërkesë drejtuar të paditurës me nr.05-..., të dt.24.02.2020; Certifikatën e vendbanimit me nr. B....., të dt.17.12.2019; Listën e pagave në emër të paditëses të lëshuar nga BRK-ës, me nr.EM ..., për muajin nëntor 2019; Vërtetimi me nr..., i dt..., lëshuar nga SHFMU “...” në Fsh..., për ditët e pranisë në punë;

Vërtetimin me nr..., i dt.03.12.2020, lëshuar nga SHFMU “..” në Fsh... K.Gjilan, për shërbim të kuzhinës dhe furnizim me ushqim; Vërtetimi i dt..., lëshuar nga SHTU “..” në Gjilan, lidhur me qmimin e biletës.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-ës si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata gjeti se kërkespadija e paditëses është e bazuar, andaj edhe e aprovoi të njejtën dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsye se:

Nga kontrata e punës me nr. .. e dt.01.09.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka krijuar mardhenie pune në SHFMU “..” në Fsh.... K.Gjilan, si Mësimdhënëse e ciklit klasor me kontrat pune në kohë të caktuar.

Nga vërtetimet me nr. .., të dt.06.01.2020, lëshuar nga SHFMU “...” në Fsh... K.Gjilan, për përvojën e punës dhe ditët e pranisë në punë, gjykata vërtetoi faktin se paditësja M. S. në institucionin e lartëcekuar arsimorë deri në nxjerrjen e kësaj prove ka 16 vite përvoj të punës dhe nga dt.18.04.2017, e deri me dt.12.03.2020, i ka gjithësejt 538 ditë të pranisë në punë.

Ne bazë të formularin së bashku me kërkesë drejtuar të paditurës me nr. 05-..., të dt.24.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësja përmes përfaqësuesit të sajë, fillimisht i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e shpërblimit jubilar, shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit në procedurë administrative.

Nga certifikatën e vendbanimin me nr. B., të dt..., lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se paditësja vendbanimin e ka në Rr.”...” nr..., në Gjilan.

Nga lista e pagave në emër të paditëses M. S. të lëshuar nga BRK-ës, me nr.EM., për muajin nëntor 2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësi pagën bazë e ka 421.00 €.

Nga vërtetimi me nr. ../3, i dt..., lëshuar nga SHFMU “..” në Fsh..., për ditët e pranisë në punë, gjykata vërtetoi faktin se paditësja M. S. në institucionin e lartëcekuar arsimorë prej dt.14.09.2020, e deri me dt.16.04.2021, i ka gjithësejt 143 ditë të pranisë në punë.

Nga vërtetimin me nr. 03-..., i dt.03.12.2020, lëshuar nga SHFMU “..” në Fsh... K.Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se institucioni arsimor i lartëcekur nuk posedon shërbim të kuzhinës, dhe as nuk ka të organizuar ndonjë lloj furnizimi me ushqim për punëtorët arsimor të kësaj shkolle.

Nga vërtetimi i dt.30.11.2020, lëshuar nga SHTU “..” në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se qmimi i biletës së udhëtimit me autobus në destinacionin Gjilan – .. dhe anasjelltas është 1.00 €.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses dhe lartësisë së kërkesës së sajë, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të dt.18.04.2017, e cila ka hyrë në fuqi menjëherë, konkretisht nenin 35 par. 5, 7 dhe 8 të kësaj Kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimroe në fuqi.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi që të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses M. S. nga Gjilani, dhe e detyroi të paditurën që paditëses t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilarë për 10 vite të përvojës së punës shumë prej 210.50 €, në vlerë prej 50% të një page bazë prej (421€), si dhe për 681 ditë të pranisë në punë ne emer të shpenzimeve të ushqimit shumë prej 1,362.00 €, kurse në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumë prej prej 476.70 €, në vlerë të 70 % të qmimit të biletës prej (1.00€), për periudhën

kohore nga data 18.04.2017 e deri më dt.16.04.2021, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë dt.10.04.2020, e deri në pagesën definitive, tërë këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata për shumat e aprovuara si më lartë u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës të dt.18.04.2017, ku në nenin 35 par.5, të po kësaj kontrate është përcaktuar se *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban, në paragrafin 7, të nenit të lartëcekur është përcaktuar se “Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit a kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”, e që në rastin konkret institucionet shkollore nuk e kanë të rregulluar ushqimin përmes restoranteve andaj edhe e obligoj të paditurën që paditëses t’ia kompesoj edhe shumën e lartëcekur në emër të ushqimit. Kurse në paragrafin 8 pika 8.1 të po të njejtit nen është përcaktuar se “Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitorjnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë...”, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura të Kontrats Kolektive të Arsimit, paditëses ia njohu një të drejtë të tillë, dhe vendosi si në dispozitiv.*

Lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligji nr.06/L-054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se *„Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Kurse Departamenti për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon çështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktit administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ marrëdhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikqyrës e më pastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentit për Çështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurse siq dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.*

Lidhur me pretendimin e të paditurës se paditësja fillimisht nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative para se të paraqes padi në gjykatë, për gjykatën edhe ky pretendim i të paditurës është i pabazuar, për arsye se në bazë të shkresave të lëndës dhe provave të administruara, përkatësisht nga Formulari me nr. të protokolit 05-..., të dt.24.02.2020, së bashku me Kërkesën për Kompensim drejtuar DKA-së në Gjiilan, nga i autorizuari i paditëses,

gjkata ka vërtetuar faktin se paditësja fillimisht iu ka drejtuar me kërkesë të paditurës për realizimin e të drejtës së sajë subjektive, por e paditura nuk është përgjigjur në kërkesën e paditëses, dhe si rrjedhojë e njëjta ka parashtruar padi në gjykatë për realizimin e një të drejte të tillë. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se meqë e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventat ndërkombëtare dhe me ligj dhe në rastet e paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës ku është thirrë në parashkrim të kërkesës se paditëses, mirëpo sipas gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, ndërsa paditësja padinë në gjykatë e ka paraqitur me dt.10.04.2020, andaj nisur nga rrethana të tilla rezulton se paditësja nuk ka pasur bazë ligjore për parashtrimin e një kërkesë të tillë para kësaj date, pra para dt.18.04.2017, çka do të thotë se padia është parashtruar në afatin ligjor të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi që sipas nenit 87 të këtij ligji, në mënyrë shprehimore është paraparë se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”, andaj nga këto arsye rezulton se padia e paditëses është parashtruar brenda afatit ligjor prej 3 viteve, dhe rrjedhimisht kërkesëpafia e paditëses nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura.

Nga se u tha më lartë, duke pasë parasysh faktin se paditëses i ka lindur e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës së sajë lidhur me kërkesën e parashtruar, e njëjta si palë e legjitimuar ka të drejtë që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, sepse, sipas nenit 245 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD) në mënyrë të qartë është paraparë se: “Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, andaj, duke pasë parasysh të cekurat më lartë, gjykata gjeti se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditëses, ku edhe vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditëses t’ia kompensojë shumën e kërkuar dhe të aprovuar nga gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit /Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017/, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komuna apo DKA-të.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk prodhon efekt për të paditurën, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës me nr.03L-068, ku në nenin 5 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe pagesës së tyre e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës.

Kamata ligjore prej 8% në vitë është përcaktuar konform nenit 382 të LMD, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se „*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*” kurse lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që e detyroi të paditurën Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, edhe atë për përpilimin e padisë nga avokati shumë prej 104 euro, për pagesën e taksës gjyqësore shumë prej 31 euro, për përfaqësimin në një seancë gjyqësore shumë prej 135 euro, apo shumë e përgjithshme prej 270 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, e konform nenit 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore Gjilan - Departamenti I Përgjithshëm**  
**C.nr. 1002/2020, i datës 01.06.2022**

**Gjyqtarja**  
Liridona Haziri Mustafa

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të të njejtit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:051085  
Datë: 08.06.2022  
Numri i dokumentit: 03110271